

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Drita Uka, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit P. P., nga fshati V., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KP-ë, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2581-1/2017 të datës 10.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Fatos Ajvazi, të akuzuarit, me date 07.09.2018 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

P. P., nga i ati P. dhe nëna R. e lindur P., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin V., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, i pa shkolluar, bujk, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 27.09.2017, rreth orës 22,05 minuta në afërsi të fshatit S. e E., Komuna Prizren, saktësisht në objektin e kompanisë “S. T.”, pronë e të dëmtuarit Z. G., në bashkë veprim edhe me të dyshuar të tjerë ende të pa identifikuar, i merr pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë i pandehuri e shfrytëzon kohën e natës shkon në objektin e kompanisë “S. T.”, ofrohen tek mjetet e punës – kamionët, duke e përdorë forcën i thyejnë kapakët e rezervuarve të cilët kanë qenë të mbyllur me qelës, nga aty marrin 30 litra naftë të cilat i kanë vendosur në bidonë, aty diktohen nga roja e objektit të kompanisë – M. K., i cili u vihet pas të pandehurit dhe të dyshuarve të tjerë ende të pa identifikuar, ku dëshmitari arrin ta identifikoj të pandehurin P. P. i cili në ato momente shtënë me armë zjarri ende të pa identifikuar në drejtim të dëshmitarit, 3-4 herë dhe e kanos me fjalët “largohu se të vrajë”, i pandehuri arrin që të ik nga vendi i ngjarjes, ndërsa afër vendit të ngjarjes është gjendur një veturë e markës “BMW”, ngjyrë e kuqe me shenjën regjistruese *numri i targës...*, e cila veturë i përket këtu të të pandehurit P. P.,

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KP-ë,

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 42 par.1 pika 1.1, 43 par.1 pika 1.2, dhe 1.3 45,46, 73, 74, 75, 76 dhe 327 par.1 pika 1.1 të KP-ës, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 Euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në raste se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me dhunë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 Euro një ditë burg, respektivisht 15 ditë burg, dhe

DENIM ME BURGIM

Në kohë zgjatje prej 3 (tre) vite burgim, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak nga data 28.09.2017 deri me datën 07.09.2018

I dëmtuari Z. (J.) G., nga fshati S. e u., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesë pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Po ashtu obligohet i akuzuari të paguaj në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej 50 Euro, si dhe në emër të mbrojtjes së viktimave shumë prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzat PP.nr.2581-1/2017 të datës 10.11.2017, kundër të akuzuarit P. P., nga fshati V., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par.2.6 lidhur me par.1 të KP-ës.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 07.09.2018, në fjalën e tij përfundimtare të përgaditur me shkrim rreksion se ka bërë rikualifikimin e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par.2.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal në veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të Kodit Penal, të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës PP/II.nr.2581-1/2017, me arsyetim se nuk janë gjendur elementet esenciale te kjo vepër penale të përshkruar si në paragrafin 2, nën par.2.6, kryesi ka pasur me vete armë apo mjet tjetër të rrezikshëm , edhe pse dëshmitari deklaroi se i akuzuari në vend ngjarje e ka gjuajtur me armë zjarri, e që arma e zjarrit apo ndonjë provë tjetër nuk është siguruar se i akuzuari në vend ngjare me vete e ka pasur armën e zjarrit.

prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e ka përgaditur me shkrim, dhe atë në kopje të mjaftueshme për të gjitha palët në procedurë, të cilën kopje me shkrim i dorëzon gjykatës, e cila fjalë përfundimtare do të jetë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, duke shtuar që për momentin nuk ka tjetër çka të shtojë.

Ngel pranë aktakuzës PP/II.nr.2581-1/2017 të datës 10.11.2017 kundër të akuzuarit Pashk Përlazar, për veprën penale vjedhje e rënda nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të Kodit Penal, i propozoj gjykatës që të akuzuarin P. P. ta dënoj dhe ti shqiptoj një dënim të paraparë në dispozitat e Kodit Penal.

Gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e kësaj aktakuze është vërtetuar në bazë të të gjitha deponimeve të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, mbajtjes së disa seancave gjyqësore këtu në këtë gjykatë, siç janë deklaratat e të dëmtuarit, deklaratat e dëshmitarit M. K., i cili natën kritike e ka parë mirë se i akuzuari P. P. ka qenë në objektin e kompanisë “S. T.”, pronë e të dëmtuarit Z. G., ku nga aty ka marrë derivate naftë nga rezervuarët e kamionëve, i njëjti në deklaratën e tij ka theksuar “nga baraka ku e kam pasë vendin e punës dola në dritare për të shikuar se çka po ndodhë, e kam vërejtur këtu të akuzuarin që po vjedhte naftë, e kishte futur një zorrë të gomës në rezervuar të kamionit dhe me anë të asaj zorre ka tërhequr naftën i ka mbushë dy kanta të plastikës, të sasisë 25 litërshe, i akuzuari në atë rast i ka thyer kapakun e rezervuarit i cili ka qenë i mbyllur me çelës, deklaratat e dëshmitarëve – zyrtarit policor, S. G. i cili në vend ngjarje ka gjete gjurmë ose pasqyrime të gomave të automjetit të markës “BMW”, deklaratës së të akuzuarit P. P. e cila është tërësisht kontradiktore me deklaratën e dhënë në fazën e hetuesisë, në fazën parapenale si dhe në shqyrtimin gjyqësor, me bindje se i akuzuari mundohet ti ikë përgjegjësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prandaj gjykata pas shqyrtimit të të gjitha këtyre provave së bashku me shkresat e lëndës, gjatë vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit duhet të ketë për bazë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilën është kryer vepra, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në veprën penale e sidomos recidivizmin e kryerjes së veprave panel të kësaj natyre nga ana e të akuzuarit P. P..

Prandaj ngel si më lart.

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokat S. M. deklaron që fjalën përfundimtare po ashtu e ka përgatitur me shkrim, dhe atë në kopje të mjaftueshme për të gjitha palët në procedurë, e cila fjalë përfundimtare me shkrim do të jetë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, e po ashtu i njëjti e elaboron edhe në pika të shkurta të njëjtën.

Duke u bazuar në analizimin e gjithë anshëm të shkresave të kësaj çështje dhe shqyrtimin e të gjitha provave të administruara, fakteve dhe dëshmive relevante të cilat janë proceduar deri me tani gjatë gjitha shqyrtimit të këtij procesi gjyqësor lidhur me vërtetimin e pretendimeve të prokurorisë të paraqitura në aktakuzën e ngritur kundër këtu të mbrojturit tim Pashk Përlazar, të akuzuar për vepër penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par.2.6 lidhur me par.1 të KPRK-së e këtë me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të argumentohet dhe vërtetohet se i mbrojturi im e ka kryer këtë vepër penale e cila i vihet në barrë.

Që në fazën fillestare hetuese në polici por edhe gjatë zbatimit të hetimeve në prokurori, nuk kanë ekzistuar dhe nuk kanë mundur të sigurohen prova materiale të ligjshme të cilat do të vërtetonin ekzistimin e dyshimit të bazuar mirë për ta mbështetur aktakuzën e ngritur për këtë

vepër penale ndaj këtu të mbrojturit tim, sa që vepra penale e përshkruar dhe e cilësuar në dispozitivin e aktakuzës sipas prokurorisë është propozuar që kjo vepër penale të provohet vetëm në bazë të shikimit të kallëzimit penal i cili fare nuk është provë, në procesverbalin mbi intervistimin e të dëmtuarit dhe dëshmitarit nga policia, në raportin e oficerit policor e që po ashtu nuk është provë që mund të administrohet, shikimit të foto dokumentacionit dhe deklaratave të dëshmitarit dhe dëmtuarit të dhëna në prokurori.

Dëshmitari M. K. lidhur me rastin ka dhënë 3 deklaratat në polici dhe atë me datë 27.09.2017, 27.09.2017, në ora 12,20 minuta dhe me datë 28.09.2017, por që të 3 deklaratat janë kundërthënëse ndërmjet veti ngase asnjëherë nuk ka deklaruar njëjtë lidhur me ngjarjen e cila ka ndodhur natën kritike me rastin e tentimit të vjedhjes së derivateve të naftës në vendin ku aj ka qenë në cilësinë e rojës, po ashtu ky dëshmitar edhe në prokurori ka deklaruar se në vendin e ngjarjes ka parë dhe hasur dy persona të moshës së re rreth 20 vjeçare duke mbajtur nga dy bidon (kanta) në duar ndërsa pasi i kishte ndjekur rreth 50 metra në këmbë e më pas edhe me automjet rreth 500 metra, kishte vërejtur edhe të akuzuarin Pashk Përlara.

Gjithashtu ky dëshmitar edhe në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjatë marrjes në pyetje nga ana e Prokurorit i njëjti ishte konfuz dhe deklarimi i tij gjatë ballafaqimit me deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ishin kundërthënëse dhe deklarata e të njëjtit ishte jo kredibile dhe jo bindëse gjë për të cilën gjykata këtij dëshmitari nuk duhet ti falë besimin.

I dëmtuari Z. G. po ashtu gjatë deklarimit të tij sikurse në polici, prokurori por edhe në deklaratën e dhënë në seancën gjyqësore, ka pohuar se në vendin e ngjarjes ka shkuar pasi e kishte lajmëruar dëshmitari – roja për rastin e ndodhur që që i njëjti ka pohuar në vendin e ngjarjes se nuk e kishte parë askënd dhe nuk kishte hasur në vendin e ngjarjes e as larg vendit të ngjarjes në kurrfarë gjurme të cilat kanë të bëjnë me vjedhjen e derivateve, qoftë ndonjë mjet eventual i cili është përdorur për kryerjen e vjedhjes edhe pse natën kritike së bashku me policinë të cilët kanë ardhur në vendin e ngjarjes kanë kontrolluar përreth vendit të ngjarjes, përkundër se ky i dëmtuar ka deklaruar se nga rezervuari i kamionit është marrur natën kritike sasia e naftës prej 30 litra, këtë nuk ka mundur të dëshmojë se si ka mundur ta vërtetojë – matë sasinë prej 30 litra nga rezervuari i kamionit dhe se pohon që vlera e dëmit është vetëm 40 euro.

Gjykata duhet të analizojë dhe vlerësojë deklaratat e dëshmitarit dhe të dëmtuarit secilën veq e veq, për të arritur që të kuptojë shkallën e besueshmërisë të deklaratave të tyre në të provuarit e ndriçimit të rrethanave të rastit.

Po ashtu me asnjë provë tjetër materiale nuk është arritur të provohet dhe vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale pasi që në shkresat e lëndës nuk ekziston raport i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga ana e policisë për të faktuar se është kryer vepra penale e vjedhjes së rëndë, ngase as nga policia nuk janë vërtetuar me prova deklaratat e dëshmitarit se “është shtënë 3herë me armë zjarri në drejtim të tije nga i akuzuari”, pasi që vet policia bashe me prezencën e dëshmitarit kanë kontrolluar hapësirën – vendin për të cilën dëshmitari ka thënë se nga aj vend është shtënë me armë zjarri, por se nuk është gjetur asnjë gjurmë apo dëshmi e cila ka të bëjë me gjuajtje nga arma e zjarrit dhe se dëshmitari ti ketë parë dhe ndjekur dy personat e panjohur me katër bidon (kanta) të mbushur duke i mbajtur në duar, as ky fakt nuk është vërtetuar pasi që

policia nuk ka hasur as në vendngjarje, afërsi, largësi apo në shtëpinë e të akuzuarit të cilat kanë shkuar ditën e nesërme çfarëdo lloj bidoni (kantë) të cilët kanë shërbyer për mbushje me naftë nga të dyshuarit e panjohur. Automjeti po ashtu që është gjetur i braktisur në fushë ditën e nesërme nga policia i cili është marrë dhe dërguar në oborr të stacionit policor, sipas raportit të oficerit policor konstatohet se automjeti i braktisur është hasur në një distancë 4 kilometra larg vendit të ngjarjes.

Po ashtu edhe nga fotot e kamionit të cilat ekzistojnë në foto albumin e policisë, sipas dëshmisë së dëshmitarit – policit F. U. të dhënë në seancë gjyqësore të datës 20.07.2018 e që i njëjti ka kryer kontrollen e mbrendshme dhe të jashtme të automjetit të markës BMW dhe fotografimin e tij, në raportin plotësuese të tije si ekspert i krim teknikës së forenzikës së policisë, ka deklaruar se nuk ka qenë në vendin e ngjarjes dhe as që ka bërë fotografimin e vendit të ngjarjes edhe pse të njëjtat fotografi janë në foto album, nuk e din se kush i ka bërë ato foto ku janë bërë dhe çka paraqesin dhe për të njëjtat foto nuk ka qenë në gjendje të deklarohet.

Njëra nga foto e kamionit mbi rezervuarin e tije shihet një kapak i rezervuarit i pa dëmtuar e po ashtu shifet e padëmtuar edhe gryka e rezervuarit të kamionit, ndërsa pretendohet se hapja e rezervuarit është bërë me thyrje dhe përdorim të forcës e që ky fakt nuk është vërtetuar dhe provuar gjithashtu nuk është gjetur çfarëdo mjeti i mundshëm i dyshuar i cili mund të jetë përdorur për thyrje dhe hapje me forcë të rezervuarit apo ndonjë mjet tjetër psh: gyp plastike i cili mund të jetë përdorur për nxjerrjen e naftës nga rezervuari. Po ashtu edhe në raportin tjetër të oficerit të policisë që gjendet në shkresat e lëndës, është konstatuar se policia në cilësinë e të dyshuarit i janë marrë gjurmët e gishtërinjve për krahasim për ekzaminimin, por nga policia nuk është dhënë asnjë raport i rezultateve të ekzaminimit të vijave papilare të akuzuarit që do të vërtetonin përputhshmërinë me gjurmët e mbetura në automjet apo në objektet tjera – në rezervuarin e kamionit.

I akuzuari në të gjitha fazat e procedurës paraprake por edhe në deklaratën e dhënë gjatë mbrojtjes në seancën gjyqësore, ka mohuar se e ka kryer këtë veprë penale edhe pse natën kritike ka pohuar se ka qenë duke u kthyer për në shtëpi nga qyteti me automjetin e markës BMW i cili është pronë e familjes – djalit të tije J. e që atë natë kishte konsumuar edhe pije alkoolike në një lokal dhe ka qenë në gjendje të dehur, ashtu që gjatë rrugës në një largësi rreth 150 metra para se të arrin tek vend punishtja e firmës “S. T.”, automjetin e kishte lënë në rrugë pa derivate-karburant, e më pas është nisur në këmbë për të shkuar dhe kërkuar naftë nga roja i vend punishtes “S. T.”, mirëpo pasi që është ofruar rreth 30 metra kishte dëgjuar duke lehur qenët dhe është larguar nga frika e tyre, me që rast ka vazhduar ashtu në gjendje të dehur në këmbë për në shtëpinë e tij.

Nga të gjitha të lartë cekurat konsiderojmë se në rastin konkret nuk janë vërtetuar pretendimet e ngritura si në aktakuzë sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se janë formuar elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë sipas kualifikimit juridik të dispozitivit të aktakuzës, mirëpo nga analizimi i të gjitha provave eventualisht mund të ekzistojnë elementet e veprës penale të vjedhjes në tentativë nga neni 326 lidhur me nenin 21 të KPRK-së.

Andaj në mungesë të provave kërkojmë që gjykata të mbrojturin tim ta lirojë nga aktakuza dhe të shpallet i pafajshëm. Njëkohësisht i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti

ndërpritet masa e arrestit shtëpiak pasi që tani e tutje kanë pushuar kushtet dhe baza ligjore për të cilën është caktuar kjo masë dhe i njëjti të mbrohet në liri deri në plotfuqishmërinë e vendimit gjyqësor.

I akuzuari deklaroi që në tërësi pajtohet dhe e përkrah fjalën përfundimtare me shkrim të mbrojtësit të tij të elaboruar edhe në pika të shkurta dhe për momentin nuk ka tjetër çka të shtoj.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 27.09.2017, rreth orës 22,05 minuta, i akuzuari në afërsi të fshatit S. e E., Komuna Prizren, saktësisht në objektin e kompanisë “S. T.”, pronë e të dëmtuarit Z. G., në bashkë veprim edhe me të dyshuar të tjerë ende të pa identifikuar, i merr pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë i pandehuri e shfrytëzon kohën e natës shkon në objektin e kompanisë “S. T.”, ofrohen tek mjetet e punës – kamionët, duke e përdorë forcën i thyejnë kapakët e rezervuarve të cilët kanë qenë të mbyllur me qelës, nga aty marrin 30 litra naftë të cilat i kanë vendosur në bidonë, aty diktohen nga roja e objektit të kompanisë – M. K., i cili u vihet pas të pandehurit dhe të dyshuarve të tjerë ende të pa identifikuar, ku dëshmitari arrin ta identifikoj të pandehurin P. P. i cili në ato momente shtënë me armë zjarri ende të pa identifikuar në drejtim të dëshmitarit, 3-4 herë dhe e kanos me fjalët “largohu se të vrajë”, i pandehuri arrin që të ik nga vendi i ngjarjes, ndërsa afër vendit të ngjarjes është gjendur një veturë e markës “BMW”, ngjyrë e kuqe me shenjën regjistruese *numri i targës...*, e cila veturë i përket këtu të të pandehurit P. P.,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar pas shqyrtimit të gjitha shkresave dhe administrimit të provave të lëndës, dhe ate deklaratës të akuzuarit, dëmtuarit – Z. G., psikiatrit pranë forenzikës psikiaatrit Dr.A. G., dëshmitarit – M. K., si dhe dëshmitarve – zyrtarëve policor A. K., S. G., L. Th. dhe F. U., si dhe provave materiale foiodokumentacioni i raportit të oficerit të datës 27.09.2017 dhe 28.09.2017, andaj gjykata pas shqyrtimit të gjitha provave të cekura dhe vlerësimit të të njëjtëve të gjitha së bashku dhe secila veç e veç, në rastin konkret ka vërtetuar që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par. 1.1 të KP-ës, duke vërtetuar paraprakisht përgjegjësin penalë juridike të akuzuarit,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëmtuarit Z. G., i cili në shqyrtimin gjyqësor me datën 22.03.2018 deklaroi: Ndërmarrja “S. T.”, është pronë e vëllezërve tonë G., ku të gjithë familjaret bashkërisht e zhvillojmë afarizmin tonë. Rreth orës 22,00 të natës kritike të datës 27.09.2017, mua më ka ftuar në telefon rojtari i kompanisë tonë, këtu dëshmitari M. K., dhe në ora 22,05 minuta kemi qenë në vendin e ngjarjes, unë dhe M., me të arritur në vendin e ngjarjes, M. më njoftoi për ngjarjen çka ka ndodhur, atëherë unë menjëherë e kam ftuar policinë, zyrtarët policor u paraqitën në vend të ngjarjes menjëherë, dhe si u paraqitën, dëshmitari M. ju shpjegoi zyrtarëve policor rastin e ndodhur, ngase ai personalisht ka qenë në vendin e ngjarjes në momentin kur është kryer vepra, dhe ai më së miri e dinë se si, kush dhe me të cilat veprime e ka kryer veprën penale në fjalë. Si pronar i ndërmarrjes veprimet e mija kanë qenë vetëm ftesa me telefon policisë.

Unë nuk kam vërejtur asnjë mjet të përshtatshëm për kryerjen e kësaj vepre në vend të ngjarjes, e vetmja që kam vërejtur dhe më ka ra në sy ka qenë që kapaku i rezervuari të naftës të një kamioni, ka qenë i hequr, dhe nga aty kam kuptuar nga M. që aty është vjedhur një sasi e naftës. e kam vërejtur një automjet që është larguar nga vendi i ngjarjes, dhe është larguar në drejtim të pa njohur për mua, i cili ka shkuar në drejtim në mes të L. dhe S. së U., pra nuk ka shkuar nga rruga e asfaltuar, por ka shkuar në rrugën e pa asfaltuar, e cila është rrugë kodrinore e pastruar dhe e mbuluar vetëm me dhe. Pasi që ka qenë natë, dhe nuk ka pasur ndriçim publik, nuk kam mundur ta vërej as llojin, as markën e as targat e regjistrimit. Të nesërmen në mëngjes kanë ardhur zyrtarët policor dhe më kanë njoftuar që në bazë të deklaratës sime se ku e kam parë largimin e automjetit të lartë cekur më larg, se si është larguar nga vendi i ngjarjes, të njëjtit kanë shkuar dhe kanë gjurmuar dhe kanë hasur një automjet të braktisur, lidhur me këtë automjet të braktisur, të njëjtit vetëm më kanë lajmëruar, dhe më kanë treguar policia se në gomat e veturës së braktisur janë gjetur gjurmë të naftës. Mua më kanë kontaktuar personalisht nëpërmjet telefonit vëllau i të akuzuarit P. P., emrin e të cilit nuk e di, dhe më ka ftuar për ta pirë një kafe, duke shtuar që dëshiron të bisedoj diçka me mua, lidhur me vëllaun e tij, këtu P. P., pse dhe arsyet tjera shtesë nuk mi ka treguar.

Unë personalisht sot e kësaj dite nuk e di se kush e ka kryer vjedhjen e naftës në natën kritike në hapësirat e ndërmarrjes tonë. Sa i përket sasisë të naftës së vjedhur atë natë në kamionin e firmës tonë, jo nuk mund ta dijë, theksova më lart që ka qenë vetëm kapaku i thyer, e sa ka qenë sasia e naftës së marr, nuk mund të di.

Po e ndiej veten të dëmtuar për sasinë e naftës që më është marr. Nuk kam tjetër çka të shtoj, pos që si palë e dëmtuar do të parashtojë kërkesë pronësoresh juridike, për lartësinë e të cilës shumë do të sqarohem në kontestin të rregullt civil.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.04.2018, eksperti psikiatrik pranë forenzikës psikiatrike, Dr. A. G., deklaroi: që ekspertiza është dorëzuar pranë administratës të forenzikës së psikiatrike me datë 23.03.2018, por arsyet se pse e njëjta nuk ka qenë në dispozicion për zyrtarin e gjykatës që ka qenë për ta marr të njëjtën, nuk e ka të qartë, i njëjti deklaroi që e ka një kopje të ekspertizës me shkrim, të cilën mund të dorëzoj sot në gjykatë, dhe ta elaboroj të njëjtën sipas kërkesës së palëve.

Në institutin e oforenzikës psikiatrike në Prishtinë me kërkesën e gjykatës është bërë intervistimi dhe ekzaminimi i të akuzuarit P. P.. intervistimin dhe ekzaminimi klinik si dhe ai ambulatorë, është bërë pasi që paraprakisht kemi qenë të njoftuar nga gjykata në bazë të shkresave të lëndës për llojin e veprës penale të akuzuarit. gjatë punës tonë ekipore në komisionin prej tre anëtarëve profesionist, të njëjtit i kemi bërë edhe ekzaminimin e CT të kokës dhe EEG, si dhe ekzaminimet tjera profesionale, dhe pas të gjitha këtyre ekzaminimeve si komision kemi ardhur në përfundim që i ekzaminuari nuk vuan nga ndonjë sëmundje mendore apo prapa mbetje mendore, i njëjti është i aftë ti kuptoj dhe ti kujtoj të gjitha veprimet e veta, si dhe pasojat e veprimeve të shkaktuara, andaj i njëjti është i aftë edhe të konsultohet me mbrojtësin e vet, të gjitha këto sjellin në përfundim që këtu i ekzaminuari është i aftë në aspektin psikik të përballet me shqyrtimit gjyqësor.

Në bazë të ekzaminimit tonë ambulator, tek i ekzaminuari nuk kemi vërejtur që i njëjti ka çrregullime as të përkohshme e aq më pak të përhershme. në raste konkrete, nëse i ekzaminuari disponon me ndonjë dokumentacion mjekësor paraprakë lidhur me mjekimin e të njëjtit për shkak të ndonjë çrregullime të përkohshëm apo të përhershëm, dhe që i ekzaminuari na ofron dokumentacion të tillë, atëherë në bazë të atij dokumentacioni edhe bëjmë hulumtimin dhe ekzaminimin psikiatrik. në rastin konkret i ekzaminuari nuk ka poseduar kurrfarë dokumentacioni të tillë për të na ofruar lidhur me çrregullimin e tij të mëhershme qoftë të përkohshme apo të mëhershme, e po ashtu në mungesë të kësaj edhe gjatë ekzaminimit tonë të drejt për drejt te ekzaminuari nuk kemi vërejtur asnjë ç rregullim mendor as të përkohshëm e as të mëhershëm.

Në bazë të ekspertimit dhe ekzaminimit të të njëjtit, ne si komision nuk kemi mundur të konstatojmë prapambetje mendore, sa i përket prapambetjes mendore e njëjta ose mund të jetë e ose mund të mos jetë, nuk ka prapambetje mendore të përkohshme apo të përhershme, në rastin konkret tek i ekzaminuari nuk kemi vërejtur fare prapa mbetje mendore.

Në momentin e ekzamenit psikiatrik theksova edhe më lartë që paraprakisht ne si ekspert i shqyrtojmë shkresat e lëndës, raportin e të ekzaminuarit nga ana e burgut të Prizrenit në rastin konkret lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, trajtimin e tij, dhe gjatë shqyrtimit të këtyre shkresave dhe këtij dokumentacioni nuk kemi gjetur askund që i njëjti në momentin e kryerjes së veprës penale të ketë pasur prapa mbeturi mendore gjegjësisht pa aftësi mendore, nga kjo rrjedh sipas konstatimit tonë që i njëjti në momentin e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi për të vlerësuar veprimet e veta, që në gjuhën juridike tek i njëjti ka qenë aftësia për të gjykuar. si rrjedhojë e kësaj te i njëjti nuk ka pasur ndryshime në aspektin psikik dhe mental në periudhën gjashtë mujore prej momentin e kryerjes së veprës penale e deri në momentin e ekzaminimit psikiatrik.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.04.2018, dëshmitari M. K., deklaroi: me datë 27.09.2017, rreth orës 22,05 minuta, në objektin e kompanisë S. T. në fshatin S. e e. K. e Prizrenit, kam qenë në vendin tim të punës, kam qenë punëtor të kësaj kompanie në cilësinë e rrojës dhe në ditën e cekur kam filluar orarin e punës në ora 18,00, dhe rreth orës 21,45 minuta të po të njëjtën natë kam dëgjuar një krisëm tek kamionet të cilët i kam ruajtur që kanë qenë në placin e kompanisë S. T., dhe nga baraka ku e kam pas vendin e punës, dola në dritare për të shikuar se çka po ndodh, dhe e kam vërejtur këtu të akuzuarin, që është prapa meje, (shikon në drejtim të akuzuarit), e pash që po vjedhtë naftë, e kishte futur një zorrë të gomës në rezervuar të kamionit, dhe me anë të asaj zorre duke e përdorur gojën për të tërhequr naftën i mbushte dy kanta të plastikës të sasisë 25 litërshe, I akuzuari ka qenë në shoqëri edhe me një person tjetër, të cilin nuk kam mundur ta identifikoj, nga arsyeja që ka qenë errësirë, ndërsa fytyrën e të akuzuarit e kam pa të qartë, ngase në vendin ku ka qëndruar i njëjti ka pasur ndriçim, pasi që reflektorët që kanë qenë në pllacin e kompanisë e kanë ndriçuar vendin ku ka qëndruar i njëjti. Kur dola në dritare të barakës, e vërejtja këtu të akuzuarin duke marr naftë, ashtu siç përshkrova më lartë, dhe me të parë ate e telefonova pronarin e kompanisë të dëmtuarin Z. G., dhe i njoftova për rastin, dhe kam vazhduar pas telefonatës të qëndroj në vendin tim, pa dal fare nga baraka. Në momentin kur kam dëgjuar zhurmën - krismën jam frikuar të dal jashtë menjëherë, paraprakisht e kam ftuar në telefon pronarin Z., i njëjti mu përgjigj, ri brenda, mos dil jashtë, unë vij për 15 minuta, i njëjti nuk erdh as masë 30 minutave, kështu që unë përsëri dola në dritare të barakës, dhe në këtë

rast dera e barakës bëri një ushtimë të vogël, të cilën ushtimë i akuzuari me shoqëruesin e tij e vërejtën dhe e dëgjuan, dhe me të vërejtur, të njëjtit filluar të largohen nga vendi i ngjarjes me vrap, atëherë unë i kam ndjekur të njëjtit duke ju thënë, ndalu, ndalu, diku rreth 20 metra, e kam vërejtur që këtu i akuzuari së bashku me shoqëruesin e tij, i kishin në duar nga dy kanta, secili nja një kantë në duart e tyre. Pasi i ndjeka 20 metra, nga vendi i ngjarjes, dhe nuk munda ti ndjek më tepër, u ktheva përsëri tek pllaci, e prita edhe pak Z., e pastaj e mora automjetin dhe shkova në drejtim ku ishin të larguat të njëjtit, dhe pas kësaj të njëjtit i vërejta diku në largësi prej 50-60 metra nga vendi ku kishte ndodhur vjedhja, i drejtova baterinë të cilën e kisha me vete, dhe në atë moment Pashku më drejtoi automatin (kallashin) në drejtimin tim dhe më tha : largohu prej këtu. Pas kësaj unë u ktheva në pllacë, pas nja 10 minutave erdhi Z., së bashku me zyrtarët policor të cilët filluan ndjekjen e të dyshuarve, ndërsa mua më dërguan në stacionin policor të policisë regjionale në L., për të dhënë deklaratë, e kam lënë të njëjtën deklaratë sa i përket përmbajtjes si e kam dhënë sot në shqyrtimin gjyqësor.

Po hapësira të cilën unë e kam ruajtur ka qenë sa oborri i gjykatës, po ka pas ndriçim elektrik, ndërsa nuk ka pas rrethoja. Kur kam dalë nga baraka i kam vërejtur dy persona, distanca mes meje dhe tyre ka qenë diku rreth 15 metra, thashë më lart që të akuzuarin P. e kam parë në fytyrë, i njëjti ka pas në kokë një kapelë të vunicës të zezë, fytyra i është vërejtur, gjatësia e të njëjtit ka qenë për afërsish 1,80 , ndërsa konstruksioni i tij fizik ka qenë plak si i plotë, kjo sa i përket këtu të akuzuarit P..

Ndërsa personi që e ka shoqëruar të njëjtin, fytyrën nuk ja kam vërejtur, por me gjatësi ka qenë pak më i shkurtë se P., mund të them diku rreth 1,70, ka qenë i moshës shumë të re, diku rreth 18-20 vjeçar,

Unë kam deklaruar njëjtë, si në polici, si në prokurori sot në gjykatë, çka kanë shkruar në ato deklarata unë nuk e di,

Unë herën e parë në natën kritike P. e kam parë të kamioni, por për ta vërtetuar më mirë që është pikërisht ky i njëjti, e kam vërtetuar në momentin kur e kam ndjekur me automjetin tim dhe kur ja kam vendosur baterinë në drejtimin e tij, dhe kur ai më është drejtuar me automat, ashtu siç përshkrova më lart.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 20.04.2018, dëshmitari M. K., në vazhdim të deklaratës së tij nga shyrtimi gjyësor me datë 04.04.2018, deklaroi: Po është e vërtet që kam dhënë një deklaratë në prokurori me datë 06.11.2017, po ashtu është e vërtet edhe që në të njëjtën deklaratë kam thënë se mbetem në tërësi pranë deklaratave të dhëna në stacionin policor lidhur me këtë çështje penale.Po qëndroj në tërësi pranë deklaratës të dhënë në prokurori.

Është e vërtet pjesërisht, ngase nuk është e vërtet fakti që kam deklaruar që të dy kanë qenë të moshës 20 vjeçare, sa më kujtohet kam deklaruar që kanë qenë dy persona por njëri ka qenë i ri e tjetri i vjetër, e ky i riu ka qenë diku i moshës 20 vjeçare, këtë e kam konstatuar në bazë të konstruktit fizik të tij, ndërsa në fytyrë nuk e kam parë, pasi që të njëjtin e kam vërejtur pas shpine, pasi që i njëjti ka qenë duke ikur, pasi që ju kam vënë pas, ndërsa personin e dytë e kam vërejtur në fytyrë, dhe me plotë përgjegjësi them që ka qenë këtu i akuzuari, (tregon në drejtim të akuzuarit P. P.), ky ka qenë personi i dytë. Dua të sqaroj përfundimisht që me të

vërejtur këtu vjedhjen në kamionin e kompanisë S. T., unë ju kam vënë pas dy personave, ashtu siç theksova më lart, të njëjtit i kam ndjekur me automjetin tim, dhe me ti hasur diku rreth 70 metra nga vendi i ngjarjes, ata ishin të ulur për skaj rrugës, kam dalur nga automjeti, e kam dhezuar baterinë që e kisha me vete, e kam vërejtur këtu të akuzuarin, ndërsa personin e dytë atë riun si theksova më lart, nuk e kam vërejt në fytyrë, pasi që i njëjti e mbulonte fytyrën me dorë, ndërsa nuk është e vërtetë që ka qenë edhe personi i tretë.

Po është e vërtetë që në pasusin e fundit të deklaratës të dhënë në prokurori, në faqen e parë të saj kam deklaruar, që pas identifikimit të fotos nr.4, se në afërsi të vendit të ngjarjes kanë qenë duke i pritur dy personat të moshës së re të cilat kanë marrë derivate të naftës me kanta dhe i njëjti në dorë i mbajnte kallashnikov dhe ka gjuajtur tri herë në drejtim të dëshmitarit,

Të akuzuarin e kam njohur herën e parë kur e kam vërejtur pasi që e kam drejtuar baterinë në drejtimin e tij, fjala është për natën kritike. Kur ka ardhur policia, e kam njoftuar policinë për të shtënë, dhe së bashku me policinë kemi shkuar në vend të ngjarjes, ku ka shtënë i akuzuari, por kur ne shkuam me polici, i akuzuari nuk ishte më në vendin e ngjarjes.

Po kemi qenë në vend të ngjarjes ku i akuzuari ka shtënë në drejtimin tim, dhe mua policia nuk më ka lejuar të afrohem në vend të ngjarjes, pasi që ju kam treguar të njëjtëve se ku ka shtënë i akuzuari, mua me automjetin zyrtarë më kanë dërguar në stacionin policor në Lubizhdë, për të dhënë deklaratën për këtë çështje penale.

Personat që i kam vërejtur kanë qenë rreth moshës 20 vjeçare, dhe në atë moment kur ja lëshova dritën me bateri dore nalu ata filluan të vraponin dhe të dytë mbanin në duar nga dy kanta me naftë ndërsa unë me veturë fillova të ndjek të njëjtit diku rreth 50-70 metra,

Në vend të ngjarjes që kanë vjedhur naftën kanë qenë dy persona., unë në polici kam deklaruar që kanë qenë dy persona, por kur i kam ndjekur këta persona, më janë dukur që kanë qenë tre, andaj edhe për këtë ndoshta qëndron konstatimi në deklaratën time në polici që kanë qenë tre persona, për ndryshe përfundimisht theksoj që kanë qenë dy persona, si në momentin e vjedhjes të naftës, e po ashtu edhe në momentin kur të njëjtit i kam hasur skaj rrugës, pasi që paraprakisht i kam ndjekur me veturë, ashtu siç theksova më lart 50-70 metra.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 12.07.2018, dëshmitari - zyrtari policor A. K., deklaron: sa i përket rastit si rast me datë 27.09.2017, në fshatin S. e E. Komuna e Prizrenit, rreth orës 22.05 minuta, kur pretendohet kryerja e veprës penale nga ana e të akuzuarit dhe atë të veprës penale vjedhje e rëndë nuk kam qenë as në vend të ngjarjes, as nuk kam qenë i ngarkuar nga ana e mbikëqyrësit të hetuesit e rastit. Pas shikimit të kallëzimit penal, me rastin si rast është marrë zyrtari policor polici hetues L. Th., ndërsa sa i përket të emrit tim të përmendur në raportin plotësues të njësisë së forenzikës të datës 29.09.2017, theksohet që unë jam hetuesi i rastit, por unë nuk kam qenë fare në vend të ngjarjes. Zyrtarë policor që e ka ekzaminuar vendin e ngjarjes, nga raporti i forenzikës, si dhe nga foto albumi që gjendet në shkresat e lëndës, vërehet që tekniku i kriminalistikës ka qenë S. G., ndërsa në bazë të përmbajtjes së dosjes të Stacionit policor vërehet që këtë lëndë e ka punuar L. Th., kolegu ynë.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 12.07.2018, dëshmitari - zyrtari policor S. G., deklaron: pas shikimit të raportit të forenzikës lidhur me ekzaminim e kryer nga ana e njësitit tonë, deklaroj: unë kam qenë personalisht në vend të ngjarjes, për rastin e vjedhjes së rëndë, me datë 27.09.2017, rreth orës 22,05 minuta, në fshatin S. e E., Komuna e Prizrenit, referohem dosjes të përpiluar me shkrim, ku kemi gjetur gjurmë ose pasqyrime të gomave, dhe pasi që automjeti i markës “BMW” është sjell në parkingun e Stacionit policor në Prizren, kemi bërë krahasime dhe nga këto krahasime ne dyshojmë që këto gjurmë kanë qenë të automjetit të cekur. A janë apo nuk janë, lidhur me ndonjë përfundim konkret rreth kësaj, janë ekspertet tjerë të cilët do të bënin ekspertizë të tillë. Unë personalisht kam shkuar në vendin e ngjarjes të nesërmen, dhe kemi kryer veprimet tona të kërkimit të ndonjë gjurme eventuale që do të na ndihmonte lidhur me provat materiale për hetimin e rastit, por fatkeqësisht nuk kemi gjetur asnjë gjurmë relevante në vendin e ngjarjes. Po kemi qenë edhe në vendin ku na ka drejtuar edhe dëshmitari i cekur, M. K. por as aty nuk kemi gjetur asnjë gjurmë të shkreptjes apo gjuajtjes me armë.

Jo nuk e kemi bërë ekzaminimin e kamionit nga rezervuari i të cilit është marr nafta, ne kemi qenë të nesërmen në vend të ngjarjes, unë personalisht është fjala, e duke pasur parasysh që në natën kritike kur edhe pretendohet kryerja e veprës, ka qenë një patrullë tjetër që e ka bërë ekzaminimin që shihet edhe nga fotot e albumit, nuk lejohet që dy herë të bëhet ekzaminimi i vendit të ngjarjes, pa lejen e prokurorit të çështjes.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 12.07.2018, dëshmitari - zyrtari policor L. Th., i njëjti deklaron: në kohën kur ka ndodhur rasti në orët e vona të mbrëmjes, unë nuk kam qenë në vend të ngjarjes, të nesërmen kur jemi paraqitur në punë nga eprori im jemi urdhëruar që të shkojmë në vendin e ngjarjes dhe të ndërmarrim veprime hetimore. Ashtu edhe kemi vepruar kemi dal në vendin e ngjarjes të nesërmen, dhe në konsultim me prokurorin kujdestar kemi marr veprimet tona të cilat i kemi paraqitur edhe në raportin tonë zyrtarë që janë pjesë përbërëse të shkresave të lëndës. Në raportin që e kemi përpiluar me shkrim janë të paraqitura në mënyrë kronologjike të gjitha veprimet që i kemi ndërmarrë në kuadër të kompetencave tona, pranë të cilit raport qëndroj në tërësi.

Të nesërmen kur kemi qenë në vend të ngjarjes së bashku me kolegët tonë, nga deklarata e viktimës jemi njoftuar që është gjuajtur me armë në drejtim të tij, por në vendin ku na ka drejtuar viktimja, nuk kemi arritur të gjejmë asgjë, ne kemi bërë ekzaminimin e gjurmëve në drejtim të gjetjes të provave materiale për rastin, por të njëjtat i kemi dërguar pranë njësisë afisë, cila mirët me gjurmët e papilare, por deri më sot nuk kemi pranuar kurrfarë njoftimi. Dua të shtoj që ekzaminimin e automjetit lidhur me gjetjen e gjurmëve, e kemi bërë në Stacionin policor në Prizren, ku edhe është tërhequr automjeti i të dyshuarit. Po fotografitë e vendit të ngjarjes në natën kritike me siguri e ka bërë patrulla policor kujdestare.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 20.07.2018, dëshmitari - zyrtari policor F. U., deklaron: me datë 28.09.2017, kam qenë në vendin tim të punës si zyrtarë policor pranë Stacionit policor në Veri, Njësi i krim teknikës, atë ditë orarin e punës e kam filluar në ora 16,00, dhe nga eprori im më është dhënë për detyrë që ta bëj fotografimin dhe kontrollimin e automjetit të markës “BMW” ngjyrë e kuqe me targa të regjistrimit *numir i targës...*, automjet ky që ka qenë në oborrin e Stacionit policor Veri, automjet ky i dyshuar për një vjedhje një natë më përpara. Detyra ime sipas eprorit ka qenë vetëm fotografimi dhe kontrollimi i të njëjtit për të shikuar mos

ka ndonjë objekt apo send në lidhje me veprën penale. Ndërsa, sa i përket ekzaminimit më të thellë të automjetit, këtë e kishin bërë përpara meje kolegët e mi, në rastin konkret kolegu S. G., dua të theksoj që unë e kam bërë vetëm kontrollimin të brendshëm të automjetit, dhe fotografimin e të njëjtit, e asgjë tjetër. Nga foto albumi i Njësisë të forenzikës dhe ate nga foto 1 deri foton 10, që gjenden nga faqja 2 deri në faqen 6 të të njëjtës, po kjo është puna ime.

Në fotografinë që është e koduar me numër 2017 – GL – 360 dhe në fotografitë pasuse vërehet një rezervuar i naftës, objekti me mbishkrimin e firmës S. T., si dhe në vazhdim është automjeti i markës “BMW” me targa të cekura më lart, i hasur në vendin e ngjarjes, si dhe fotografit tjera nga vendi i ngjarjes, nga përvoja ime e deritashme, nga forma dhe lloji e fotografive, këto fotografi sipas mendimit tim të lirë i ka bërë patrulla e cila ka qenë në vend të ngjarjes, apo hetuesit policor, të cilët kanë qenë në vend të ngjarjes. Unë jap përgjegjësi vetëm për foto albumin që përmban gjashtë fletë të formatit A4 dhe 10 fotografi, të cilin foto album edhe e kam nënshkruar me nënshkrimin tim, për pjesën përbërëse dhe shtesë, për ate nuk di as të përgjigjem.

Jo në rastin konkret nuk kam qenë i ftuar, i vetmi veprimi imi si ekspert i forenzikës në këtë çështje ka qenë ate që e theksova më lart, fotografimi dhe shikimi i brendshëm i automjetit. Theksova edhe më herët, po e përsërisë edhe një herë, detyra ime ka qenë vetëm fotografimi dhe kontrollimi i brendshëm i automjetit në stacionin policor, e tërë këtë e kam bërë të nesërmen, ndërsa veprimet e veprës penale janë kryer një natë më përpara, atëherë nga kjo unë nuk jam kompetent për asnjë veprim të ndërmarr nga organet kompetente në vendin, kohën kur ka ndodhur kjo vepër penale.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 20.07.2018, është bërë shikimi në foto dokumentacionit në raportin e oficerit të datës 27.09.2017 dhe 28.09.2017,

Prokurori i shtetit deklaron që duke pasur parasysh rrjedhën e deritashme të shqyrtimit gjyqësor, dëgjimin e të dëmtuarit, dëshmitarëve, konsideroj që këto i kanë konsumuar provat e propozuara në aktakuzë për shikim dhe ate të kallëzimit penal të paraqitur nga Policia e Kosovës, Stacionit policor në Veri – Prizren, sektori i hetimeve me numër 2017-GL-360 të datës 29.09.2017, e po ashtu nga të cekurat janë konsumuar edhe provat e propozuara dhe ate leximi i procesverbaleve mbi intervistimin e të dëmtuarve, të dyshuarve të dhënë në Stacionin policor në Prizren – Veri, po ashtu janë konsumuar edhe leximi i procesverbaleve mbi intervistimin e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve si dhe të pandehurit të dhënë në Prokurorin Themelore në Prizren, andaj nga të gjitha të cekurat, tërhiqemi nga leximi i shkresave të cekurat të propozuara si në aktakuzë.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 28.08 .2018, i akuzuari P. P., në mbrojtjen e vet deklaron: nëse është fjala për rastin i cili më vihet në barë, unë atë ditë kam qëndruar në shtëpi gati tërë ditën, dhe në orët e mbrëmjes nuk më kujtohet saktë ora, me automjetin tim të markës “BMW” ngjyrë e kuqe kam shkuar në një lokal ku ka muzikë të gjallë, para daljes në rrugën tranzitore. Vetë kam qenë në automjet, kam shkuar në lokalin i cili gjendet ashtu si theksova më lart dhe aty kam qëndruar sa më kujtohet deri në orën 01,00 – 02,00 pas mesnate. Pasi që keni dal nga lokali kam shkuar për në shtëpi. Kam shkuar me automjetin tim të cekur më lart “BMW”. Gjatë shkuarjes në shtëpi nga lokali, nuk e di se ku jam ndalur, nuk kam mundur ta

identifikoj vendin, pasi që kam qenë nën ndikimin e alkoolit, pasi që gjatë qëndrimit në lokal, kam konsumuar sasi të mëdha të birave dhe të venës, e vetmja gjë që më kujtohet është se më është ndalur automjeti për shkak të mungesës së derivateve, pasi që më është ndalur automjeti për shkak të mungesës së derivateve kam shkuar tek ndërmarrja “S. T.”, e cila ka pasur distancë nga vendi ku unë e kam lënë automjetin diku rreth 150 metra, kam shkuar për të kërkuar naftë, edhe pse kam qenë në gjendje të dehur, unë kam pasur ndërmend të marr naftën me pritje deri nesër për të ja bërë pagesën, kur jam paraqitur në pllacin – depon e ndërmarrjes pra punishten e të dëmtuarit, diku pas 10-15 minuta, është paraqitur rroja i ndërmarrjes, për momentin nuk më kujtohet kush ka qenë ai, e as që e kam njohur. Me të vërejtur rrojën, i njëjti më ka drejtuar baterinë – dritën në drejtimin tim, andaj nga frika se mos i njëjti mund të më sulmoj, të më shkaktoj ndonjë lëndim, jam larguar nga vendi i ngjarjes, dhe ate në drejtim të shtëpisë sime ashtu në këmbë.

Gjatë qëndrimit tim në paraburgim, me rastin e vizitës të djalit tim, i njëjti më ka njoftuar që këtu rroja i ndërmarrjes S. T., pas këtyre veprimeve të mija e kishte lajmëruar policinë, si dhe pronarin e ndërmarrjes, e po ashtu i njëjti me automjetin e tij më kishte ndjekur nga pas. Këto të cekura më lart, mua personalisht nuk më kujtohen, por këto i kam kuptuar më vonë, ashtu siç theksova më lart gjatë vizitës të djalit tim në Qendrën të paraburgimit.

Pasi që jam nisur në drejtim të shtëpisë, nuk e di, nuk më kujtohet a më ka ndjekur dikush nga pas qoftë me këmbë, qoftë me ndonjë automjet. Unë e di vetëm që kam hequr shumë derisa kam shkuar në shtëpi atë natë, ngase për shkak të konsumimit të alkoolit të tepër jam rrëzuar disa herë. Automjeti më ka lënë pa derivate diku rreth 150 metra para se të arrij tek “S. T.”, Kur kam arritur tek shtëpia, tek të nesërmen rreth orës 13,00 – 14,00, pasi që më ka lëshuar pija e kam parë vetën që jam në shtëpi, kur dhe si kam arritur në shtëpi, në çfarë kohe, në çfarë mënyrë, absolutisht për shkak të dehjes së madhe nuk më kujtohet.

Diku në orët e pas ditës, pra të nesërmen, pasi që jam këndellur, kanë ardhur zyrtarët e policisë, të cilët më kanë ftuar në bisedë në hapësirat e policisë, më kanë pyetur për rastin e ndodhur një natë përpara, ku kam qenë, kur kam qenë, me kënd kam qenë, ashtu siç përshkrova edhe sot në shqyrtimin gjyqësor, por edhe atyre ju tregova siç po deklaroj tani në shqyrtim, që për shkak të gjendjes të dehur nuk më janë kujtuar veprimet konkrete.

Të nesërmen kur jam këndellur, apo jam larguar nga dehja, jo, nuk e di, a jam interesuar se ku e kam automjetin “BMW” ngjyrë të kuqe. por e di që automjetin e kam vërejtur në Stacionin policor në Veri, kur kam shkuar në bisedë, pasi që më ka ftuar policia. Kur ka ardhur djali im dy javë pas ndalimit, të më vizitoj në qendrën e paraburgimit, i njëjti më ka njoftuar që automjetin e kanë marr zyrtarët policor.

Kur kanë qenë zyrtarët policor vetëm më kanë ftuar në stacionin policor, kur kam arritur në stacionin policor, të njëjtit më kanë njoftuar që shkak është automjeti i kuq i markës “BMW” për ndryshe automjeti im, në automjet gjatë kontrollit të të njëjtit, më kanë njoftuar që kanë hasur një dorëz të kuqe, e cila dorëz ka qëlluar rastësisht në automjet, duke lozur fëmijët, se çka kanë shkruar zyrtarët policor pastaj, unë nuk e di.

Të nesërmen kur kanë ardhur zyrtarët policor për të më ftuar në polici, djali im J. atë ditë ka qenë tek dajat e vet, pra nuk ka qenë në shtëpi. Jo nuk e di kush e ka marr automjetin tim nga rruga dhe ka larguar në Stacionin policor. Po kur kam ardhur në Stacionin policor mi kanë marr gjurmët e gishtave.

Unë kam shkuar për të marr naftë, siç deklarova më lart, po me të vërejtur rrojën e të dëmtuarit, jam larguar nga vendi.

Me të vërtetë ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk mund të shkjarohem lidhur me atë cila është e vërteta deklarata që kam dhënë sot në gjykatë, apo deklarata e dhënë me datë 12.10.2017 pranë prokurorisë themelore në Prizren Departamenti përgjithshëm në fazën hetimore, në deklaratën time nën prezencën e avokati ku kam deklaruar dhe atë në faqen e dytë në pasurinë e dytë të deklaratës time të përshkruar në katër reshta ku kam deklaruar e që më është lexuar deklarata e cekur më lartë

Unë personalisht nuk posedoj leje të vozitjes, por automjetin e drejtoj, për nevojat të mija të përditshme, natën kritike është e vërtetë që e kam drejtuar automjetin, ndërsa sa i përket përgjigjes tek prokuroria që nuk di të vozisë, me të vërtetë nuk e di si kam deklaruar ashtu, kam qenë i stresuar, andaj ekziston mundësia që jam përgjigjur ashtu. Po theksoj që me të vërtetë nuk më kujtohen detalet, vuaj nga tensioni gjakut, nervoza, andaj edhe për këtë nuk më kujtohen detalet.

Po e di vendin se ku gjendet punishtja e ndërmarrjes “S. T.”, unë personalisht nuk e njoh pronarin, por vëllau im ka bashkë punuar me ta në disa projekte të ndërtimit në fshatin tonë V.. Jo nuk e kam njohur përpara rrojën, këtu dëshmitarin M., theksoava që nga ndërmarrja S. T., vetëm një nip e tyre e njoh, e familjarët tjerë e punëtorët nuk i njoh.

Në natën kritike kur kam shkuar tek punishtja e S. T. për tu furnizuar me naftë, a keni vërejtur në punishte fillimisht disa kamion, kanë qenë diku 5-6 nuk më kujtohet saktësisht, jam afruar diku rreth 30 metra tek kamionët, në atë moment një qenë ka filluar të leh, nga kjo lehje e qenit ka dal rroja, më ka drejtuar dritën – baterinë, andaj edhe unë jam larguar nga vendi i ngjarjes. Ndriçimi në vendin e ngjarjes ka qenë nga dritat e ndriçimit publik, e po ashtu në punishte e kam vërejtur një dritë – lamp që ka qenë e ndezur. Në natën kritike jo nuk kam pasur armë të zjarrit me vete, nuk kam pasur nevojë as të mbajë, ngase nuk jam në ngatresë me askënd, askujt nuk i kam borxh, pse të mbajë atëherë armë.

Unë sa e di edhe pse kam qenë në gjendje të dehur siç theksova edhe më lart, nuk e di dhe jam i bindur që nuk i kam thënë asnjë fjalë dëshmitarit, këtu rrojës të ndërmarrjes. Natën kritike jo nuk kam pasur automjet bidonë – kanta.

Në moment të shkuarjes tek e dëmtuara, jo nuk kam pasur me vete ndonjë mjet mekanik, kaqavellë – shtrafciger, danë, apo diçka të ngjashme ndonjë mjet të fortë.

Atë ditë po kam konsumuar alkool edhe gjatë ditës, në shtëpi kam konsumuar 5-6 bira, kur kam shkuar në lokal fillimisht kam pirë raki, pastaj venë dhe bira, të gjitha i kam përzier, dhe

nga kjo përzierje e pijeve edhe jam dehur, andaj edhe nuk më kujtohen disa detale me të cilat u ballafaqova sot gjatë shqyrtimit.

I akuzuari në fund deklaroi që ja lë në vlerësim prokurorisë dhe gjykatës këtë çështje për ta zgjedhur.

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata në mënyrë të plotë dhe të saktë ka vërtetuar në tërsi gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës dhe atë në bazë të deklaratave të dëmtuarit – Z. G., dëshmitarit – M. K., të cilët në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të qartë në mënyrë kronologjike përshkruan tërë veprimet e të akuzuarit, ku nga deklaratimet e tyre të cilat në tërësinë e tyre janë identike në përmbajtjen e tyre, e të cilat deklarata poashtu përputhen edhe me deklaratat e dëshmitarëve – zyrtarëve policor A. K., S. G., L. Th. dhe F. U., si dhe nga provat materiale të administruara dhe ato foiodokumentacioni i raportit të oficerit të datës 27.09.2017 dhe 28.09.2017, andaj gjykata pas shqyrtimit të gjitha provave të cekura dhe vlerësimit të të njëjtëve të gjitha së bashku dhe secila veç e veç, në rastin konkret ka vërtetuar që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par. 1.1 të KP-ës, duke vërtetuar paraprakisht përgjegjësinë penalo juridike të akuzuarit, e cila përgjegjësi vërtetohet nga ana e psikiatrit pranë forenzikës psikiatrike Dr.A. G.,

Provave të cekura më lartë të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata në tërësi ju fali besimin pai që të njëjtat janë identike dhe në përputhshmëri të plotë me njëra tjetrën dhe si të tilla si tërësi vërtetojnë në tërësi gjendjen e plotë dhe të saktë faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës

Ndërsa sa i përket deklaratës të dëmtuarit P. P., të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ku i njëjti përshkruan ngjarjen pa specifikuar konkretisht asnjë veprim të vetin në ditën dhe kohën e cekur kur ka ndodhur ngjarja dhe vepra penale e cila i vihet në barrë, po ashtu pjesën me të madhe gjatë mbrojtjes së vet i akuzuari deklaroi se nuk i kujtohen momentet dhe detalet e precizuara në aktakuzë e arsytimi për këtë sipas të njëjtit është konsumimi i sasisë të madhe të alkoholit, i vetmi detal dhe pjesë nga tërë ngjarja të akuzuarit i kujtohet sipas tij vetëm momenti kur automjeti i është fikur për shkak që ka mbetur pa derivate dhe se automjeti është ndalur afër ndërmarrjes “S. T.”, dhe nga aty nga rezervuarët e kamionit marrin sasi të derivateve dhe me të vërejtur rojën e kompanisë largohet nga vendi i ngjarjes duke shkuar në shtëpi ashtu i dehur, pa e ditur as ku e ka lënë automjetin e tij të markës “BMW”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit numri i targës..., të cilin e ka parë të nesërmen në stacionin policor në Prizren, kur ka shkuar për të dhënë deklaratë, e pas dy javë qëndrimi në qendrën e paraburgimit, me rastin e vizitës nga djali i tij ka kuptuar pasi që i njëjti e ka njoftuar se automjetin e cekur e kishte marrë policia, deklaratës së tillë gjykata nuk ja fali besimin ngase sipas mendimit të gjykatës e njëjta nuk është e bazuar dhe është tepër sipërfaqësore dhe si e tillë nuk mund të qëndroj si e bazuar për ta bindur gjykatën që të njëjtës të ja fal besimin aq më shumë që e njëjta është mjaft e zbehtë sa i përket veprimeve të tij personale si dhe të rojës të kompanisë të dëmtuar, e aq më shumë e njëjta është në kundërshtim me vetveten në drejtim që i njëjti gjatë deklaratës së vet ka ndryshuar deklaratën gjatë shqyrtimit gjyqësor në krahasim me deklaratën e dhënë në prokurori, andaj i njëjti për shkak të këtyre deklaratave kundërtëne dhe në pjesën më të madhe të tyre diametralisht të kundërta për të njëjtën çështje penale gjatë shqyrtimit gjyqësor është ballafaquar disa herë me deklaratat e

veta nga ana e prokurorit. Qëllimi i të njëjtit si për faktin e cekur dhe po ashtu edhe gjatë deklaratës së tij të dhënë në mbrojtjen e vet, sipas mendimit të gjykatës është vetëm shmangia nga përgjegjësia penale dhe vepra e cila i vihet në barrë, ngase në bazë të provave të cekura të cilave gjykata në tërësi ju fali besimin dhe ate deklaratës të dëmtuarit dhe dëshmitarit M. K., si dhe deklarave të zyrtarëve policor A. K., S. G., L. Th. dhe F. U. si dhe nga provat materiale të administruara dhe ate foiodokumentacioni i raportit të oficerit të datës 27.09.2017 dhe 28.09.2017, gjykata pas administrimit të provave, shqyrtimit dhe vlerësimit të njëjtave, dhe ate secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka vërtetuar gjendjen e plotë faktike se veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale që si tërësi përbjnë figurën e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KP-ë, të pëtkshkruar si dispozitiv të aktgjykimit dhe për këtë vendosi që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj sipas ligjit si dhe paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Po ashtu gjykata shqyrtoi edhe fjalën përfundimtare të mbrojtësit të akuzuarit, por gjatë shqyrtimit të së njëjtës, vlerësimit të pretendimeve dhe të dhënave në të njëjtën gjykata konstatoi dhe nuk gjeti ndonjë provë, fakt apo rrethanë bindëse dhe të mbshtetur në ndonjë provë po ashtu bindëse me të cilën gjykata do të mund të falte besimin, arsyet dhe pretendimet si dhe të dhënat të theksuara në fjalën përfundimtare të të njëjtit ishin të pamshtetura, të paargumentuara dhe si të tilla nuk mund të qëndrojnë andaj sipas mendimit të gjykatës e njëjta nuk arriti që të bind gjykatën për gjendjen faktike ndryshe pos asaj të vërtetuar në aktgjykim.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë rënduese gjykata ka pasur parasysh pasojën e shkaktuar nga veprimet e të akuzuarit gjaegjësisht me anë të kësaj veprë penale të dëmtuarit i është cenuar dhe dëmtuar pasuria, i akuzuari është përsëritës i veprave penale të kësaj natyre apo të ngjashme, te i njëjti nga të cekurat gjykata konstatoi se i njëjti ka prirje për kryerjen e veprave penale, i njëjti ka shkelur edhe rregullat e arrestit shtëpiak si masë që sipas vendimit të gjykatës e njëjta i është zovendësuar me masën e paraburgimit nën të cilën masë ka qenë paraprakisht, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, është person familjar, baba i pesë fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi të akuzuarit dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro si dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësive të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP-ës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2111/2017 me datë 07.09.2017

Procesmbajtësja
Drita Uka,

Gjyqtari,
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate,